

Udhëzime terapeutike për mjekimin e zgjebes



Të dashur prindër, të dashur pacientë,

tek ju apo tek fëmija është konstatuar infektimi nga parazitët zgjebes dhe mjeku juaj j'ua ka rekomanduar të merrni kremi permethrin-biomo 5%. Në gjuhën shkencore infektimi nga parazitët e zgjebes quhet edhe scabies. Me siguri, që ju jeni të shqetësuar, se si të shpëtoni sërish nga këta parazitë. Për këtë arsye, ne kemi bërë një përmbledhje informacionesh, të cilat shpjegojnë prejardhjen e scabies dhe njëkohësisht j'ua ndihmojnë, të aplikoni kremi permethrin-biomo 5% në mënyrën e duhur.

Çfarë është scabies?

Parazitët e scabies janë vetëm rreth 0,3 - 0,4 mm, të cilët me nofullat e tyre të forta, gërmojnë kanale të vogla në shtresën e sipërme të lëkurës së njeriut. Zona të caktuara të trupit, si p.sh. duart dhe këmbët, pjesa e përparme e bërrylit apo zonat gjenitale, janë zonat e preferuara të këtyre parazitëve. Në pjesët e infektuara shkaktohen kruajtje të forta, sidomos gjatë natës në ngrohtësinë e shtratit. Me sy të lirë apo me një thjerrë, mund të dallohen kanalizime të parregullta, shpesh në formë presjeje. Si pasojë e reaksionit ndaj infeksionit dhe prej kruajtjes në pjesën e prekura, krijohen zakonisht nyje në formë të stërzgjatur ose edhe flluska, të cilat me kalimin e kohës mund të krijojnë kore. Nëse ju apo fëmija juaj jeni të prekur nga paraziti i scabies, kjo zakonisht nuk është pasojë e mungesës së higjienës personale. Paraziti nuk bën dallim në moshën, pastërtinë apo pozicionin shoqëror të njerëzve. Megjithatë marrja e masave higjienike është shumë e rëndësishme, nëse ju dëshironi ta hiqni qafe një herë e mirë këtë murtajë. Udhëzimet për këtë, do të gjeni më poshtë.

Si ndodh transmetimi i scabies?

Paraziti i scabies transmetohet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë të lëkurës nga njëri person te tjetri. Shfaqja e simptomave të para ndodh zakonisht 2 - 6 javë pas transmetimit, në rastin e infektimit rishtas edhe më pak. Para së gjithash në mjediset dhe institucionet e kolektive, si p.sh. në shkollë, kopshte fëmijësh, azilet e apo shtëpitë e pleqve, mund të jetë e shpeshtë shfaqja e këtyre rasteve. Kjo vlen veçanërisht, kur mjediset e fjetjes janë të përbashkëta. Në raste të rralla është i mundur edhe transmetimi përmes shtrorave të shtratit, tapicerisë apo batanijeve. Parazitët e scabies mund të mbijetojnë tri deri në katër ditë jashtë trupit, në temperatura të ulëta dhe të lagështa edhe shumë më gjatë.


Kremi ynë permethrin-biomo® 5% – i frymëzuar nga natyra

Përbërësi veprues në kremi permethrin-biomo është permethrina. Permethrin është zhvillimi i mëtejshëm i një substance natyrore, e cila gjendet te bima e krizantemës. Kështu u krijua kjo substancë vepruese, e cila siguron shfarosjen e parazitëve, por që për njerëzit është i padëmshëm.

INFO


Kremi permethrin-biomo 5% është kontrolluar nga Agjencia Federale e Mjedisit si një mjet kundër parazitëve të zgjebes (Sarcoptes scabiei) në përputhje me nenin §18 të Ligjit për Mbrojtjen ndaj Infeksioneve dhe është i miratuar për dezinfektimet e urdhëruara zyrtarisht (B-Nr. B-0305-00-00).

LYERJA



Shpërhapeni kremin në të gjithë trupin. Kokën edhe fytyrën mund ta lini pa lyer, nëse nuk janë të prekura nga paraziti (scabies) ose lyeni vetëm pjesët e prekurra në këto zona.

VEPRIMI



Lëreni kremin të veprorë për të paktën 8 orë, për shembull gjatë natës.

SHPËLARJA



Pas kohës së veprimit bëni dush ose lani mbetjet e kremit në lëkurë.

Aplikimi i kremit permethrin-biomo® 5 %

- Shpërhapeni kremin në të gjithë trupin duke përfshirë gushën, qafën, shuplakat e duarve dhe tabanët e këmbëve.
- Gjatë shpërhapjes duhet të bëni kujdes ta aplikoni kremin mirë, veçanërisht në zonat mes gishtërinjve, si të duarve edhe të këmbëve (edhe poshtë thonjve), në kyçet e duarve, bërrylat, sqetullat, te pjesët e jashtme të organeve gjenitale edhe veçanërisht te të ndenjurat.
- Mos i lani duart as pasi të keni shpërhapur kremin dhe as gjatë gjithë kohës së veprimit! Përndryshe lyejini sërish me krem zonat e lara. Mbajtja e dorezave prej pambuku është shumë praktike. Përdorimi i tyre tek fëmijët mund të jetë shumë i dobishëm. Nëse ju duhet të shkoni në tualet gjatë trajtimit, atëherë mund të vishni doreza gome sipër dorezave të pambukut.
- Lëreni kremin të veprorë në lëkurë për të paktën tetë orë, për shembull gjatë natës.
- Pas kohës së veprimit duhet të bëni dush apo ta lani lëkurën me ujë dhe sapun. Pas shpëlarjes së kremit rekomandohet të merren masa përkujdesjeje ndaj lëkurës – si kremra balsam apo banja vaji. Në këtë mënyrë ju ndihmoni në normalizimin e lëkurës në zonat e prekura, të cilat janë kryesisht të thata.
- Zakonisht, një përdorim i një-hershëm është i mjaftueshëm. Në rastin e një infektimi të fortë ose një riinfektimi nga paraziti scabies, mund të përsëritet aplikimi pas rreth 14 ditësh.
- Pas dy ose katër javësh, në rast mos-përmirësimi apo në rast se krijohen kanale të reja të parazitëve, duhet të kryhet një kontroll nga mjeku.
- Zakonisht, kruajtja zgjat disa ditë deri në disa javë – edhe në rastin kur pas trajtimit të suksesshëm, parazitët janë eliminuar tashmë. Për lehtësimin e kruajtjeve mund të merrni preparate të rekomanduara nga mjeku juaj.
- Personat e afërm duhet gjithashtu të kryejnë një kontroll të imtësishëm dhe të marrin gjithashtu një trajtim efektiv, nëse dyshohet të kenë marrë infektimin e zgjebes. Në raste të veçanta, p. sh. brenda një familjeje apo një institucioni të përbashkët, është e udhës, që të trajtohen edhe personat, të cilët nuk kanë simptoma të dukshme të zgjebes. Konsultohuni me mjekun tuaj për këtë.

Çfarë mund të bëni tjetër?

- Ju duhet të shkurtoni thonjtë dhe ti pastroni ata me kujdes, sepse ata ofrojnë vend për t'u fshehur shkaktarëve të sëmundjes dhe gjatë kruajtjeve të forta mund të çojnë në lëndime.
- Për një periudhë prej 4 ditësh ndërroni teshat dhe shtrorjat e shtratit përditë dhe lajini ato në temperaturë nga 60 °C e sipër.
- Tekstilet mund të çlirohen nga parazitët gjatë larjes në lavatriçe, në temperaturën minimale 60 °C.
- Rrobat, të cilat nuk mund të lahen në temperatura të paktën 60 °C si edhe sende të tjera, si p. sh. lodrat prej pelushi apo këpucët duhet të mbahen për disa ditë të mbyllura në një qese plastike.
- Tapetet dhe tapiceritë duhet të pastrohen mirë me fshesë me korrent. Zakonisht, kjo është e mjaftueshme për të eliminuar parazitët, që mund të jenë shpërndarë në banesë.
- Mos përdorni rrobat, peshqirët, jastëkët, mbulesat, krehrin etj. të personave të tjerë në familje.
- Mjetet për luftimin e parazitëve (pesticidet) nuk janë të dobishme në shtëpi. Solucionet dezinfektuese janë joefektive kundër parazitëve të zgjebes.

Shënim: Përmbajtja e kësaj fletë informacioni jepet vetëm për qëllime informative dhe në asnjë mënyrë nuk është një zëvendësim për konsultimin e një mjeku. Nëse keni pyetje specifike, ju lutemi kontaktoni një mjek.